



1006/45-12
Vendim
26.10/2021

Në bazë të dispozitave të nenit 2, nenit 3 dhe 5 të nenit 15, neni 40, nenit 41, nenit 42 të Statutit të Kolegjit të Mesëm të Lartë UBT, në përputhje me Vendimin Nr. 1248, datë 25.02.2022, Kryetari i Këshillit Drejtues, miratoi këtë:

V E N D I M

Shpallet konkursi i rregullt publik për pranimin dhe regjistrimin e nxënësve të rinj, për vitin e ri shkollor 2022/2023, si në vijim

Nr.	Numri i paraleleve	Numri i nxënësve	Lëmia dhe profili	Gjithsejt
1	6	25	Gjimnazi Natyror	300
2	6	25	Gjimnazi Gjuhësor	300
3	6	25	Bashëpunëtor profesional i infermierisë	300
4	3	25	Teknik i Farmacisë	75
5	6	25	Teknik i laboratorit mjekësor	300
6	6	25	Asistent dentar	300

Shpallja e konkursit për regjistrimin e nxënësve të rinj, bëhet në mjetet e përditshme të informimit publik. Paga për një vit shkollor është në vlerë prej 1500 Euro.

Të drejtën e konkurrimit dhe të regjistrimit e kanë të gjithë kandidatët të cilët e kanë përfunduar shkollimin e mesëm të ulët dhe të cilët e kanë përfunduar me sukses testin e arritshmërisë.

Nxënësit mund të aplikojnë online përmes ueb faqes: <http://gjimnazi.ubt-uni.net/#> për Gjimnaze dhe nga <http://shm.ubt-uni.net/> për Shkolla Profesionale të Mjekësisë, ose në mënyrë fizike në ambientet e UBT-së.

Kushtet për regjistrim

Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazeve dhe të shkollave profesionale, për vitin shkollor 2022/2023, mund të konkurrojnë nxënësit të cilët kanë përfunduar shkollimin e mesëm të ultë në Kosovë, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e nëntë (IX) jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASH dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

Kriteret për regjistrim Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret:

- Nota mesatare e të gjitha lëndëve (klasat 6-9) (60%) 60 pikë



- Nota mesatare nga lëndët prioritare (klasat 6-9) (40%) 40 pikë
- Kriteri i lëndëve prioritare nga sukcesi për gjimnaz dhe shkollën e mesme të mjekësisë është që mesatarja e këtyre lëndë vetë jetë 4 e më lartë (Së pari gjendet mesatarja e 4 lëndëve prioritet veç e veç, pastaj mesatarja e mesatareve të atyre lëndëve).

Nxënësit të cilit aplikojnë, i bashkëngjisin aplikacionit:

1. Certifikatën kalimit të testit të arritshmerisë për klasat e nënta – origjinale ose kopje të noterizuar;
2. Diplomën e shkollës së mesme të ulët – origjinale ose kopje të noterizuar;
3. Dëftesat e shkollës së mesme të ulët – origjinale ose kopje të noterizuar;
4. Ekstrakti i lindjes, si dhe
5. Dy fotografi të formatit të pasaportës.

Regjistrimi i nxënësve realizohet prej ditës së nënshkrimit të vendimit deri me datën 31.08.2022.

Të sigurohet cilësia e pranimit të nxënësve nëpërmjet suksesit më të mirë nga shkollimi i mesëm i ulët, ashtu siç është përcaktuar në konkurs.

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset shërbimi përkatës i UBT-ës.

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Këshillit Drejtues i UBT-së
Prof. Dr. Edmond Hajrizi